

“Sigurimi i pasurisë së Albcontrol”

Rreziqet që kërkohen të mbulohen nga polica e sigurimit

1. Rreziku nga zjarret;
2. Rreziku i rrufesë;
3. Rreziku nga shpërthimet;
4. Rreziku nga stuhitë;
5. Rreziku i forcave të natyrës;
6. Rreziku i shkarjes së tokës;
7. Rreziku i Përmbytjes;
8. Rreziku i rënies së avionëve, pjesëve ose ngarkesave të tyre mbi pasurinë e siguruar të Shoqërisë;
9. Rreziku e dëmshpërblimi i aseteve të lidhura me humbjen, dëmtimin dhe shkatërrimin që mund të vijë si pasojë e përpjekjeve për shuarjen e zjarrit ose të lëvizjeve që lidhen me çdonjërin prej ngjarjeve të mësipërme;
10. Rreziku e dëmshpërblimi i aseteve të lidhura me humbjen, dëmtimin dhe shkatërrimin që mund të vijë si pasojë e tentativave për kryerjen e vjedhjeve me dhunë, të veprimeve të kryera nga aktet terroriste;
11. Sigurimi duhet të marrë përsipër mbulimin total të dëmit të ndodhur si pasojë e një ngjarje sigurimi nga rreziqet e mësipërme.
12. Sigurimi është përgjegjës për mbulimin e kostos së riparimit të dëmit të ngjarjes së ndodhur, duke kthyer asetën e dëmtuar në gjëndjen e mëparshme brenda një periudhe kohore 10 ditore. Në rastet e aseteve që janë sisteme tekniko-operacional, rikthimi në gjëndjen e mëparshme nënkupton rikthimin në operativitet të plotë.

Termat e referencës për sigurimin e pasurisë

a. Sigurimi nga rreziku i zjarrit dhe rreziqet shtesë që shoqërojnë atë.

- Zjarr do të konsiderohet të jetë një formë e djegjes me flakë e të mirave materiale, e aftë të vetëpërhapet dhe të vetëzgjerohet. Ky përkufizim përfshin cdo formë të lindjes dhe krijimit të zjarrit që prek objektet e siguruar nga zjarri.
- Rrufe do të konsiderohet të jetë një shkrepje e shkarkesë elektrike e cila godet një objekt direkt ose indirekt.
- Eksplozion do të konsiderohet të jetë një çlirim i papritur i energjisë i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve në përpjekje për zgjerim. Në se shkak për shpërthimin brenda enës është një reaksion kimik, atëherë do të dëmshpërblehet çdo dëmtim i enës dhe në se paretet e saj nuk janë shkatërruar.
- Rënie avionësh ose pjesë të tij mbi objektet e siguruar.

b. Sigurimi nga rreziku i tërmetit dhe rreziqet shtesë që e shoqërojnë atë.

-Tërmeti duhet të jetë i regjistruar nga Stacionet Sizmike, si dhe të ketë një vlerë jo më të vogël se 3 ballë sipas shkallës Rihter.

c. Sigurimi nga rreziku i stuhisë dhe rreziqet shtesë që shoqërojnë atë.

- Stuhi do të konsiderohet një lëvizje ajri me forcë jo më të vogël se 8 shkallë (17.2 m/sek. ose 62 km/orë) shkaktuar nga kushtet meteorologjike. Në qoftë se nuk ka matje nga stacionet meteorologjike që kjo forcë ere mbizotëron kur ndodh një ngjarje, do të jetë e mjaftueshme në qoftë se I Siguruari (*Albcontrol*) sjell të dhëna që në afërsi të zonës së siguruar, stuhia shkakton humbje ose dëme në ndërtesat e ndërtuara sic duhet ose në objektet e tjera me rezistencë të njëjtë.

Kompania Siguruese do të paguaj dëmshpërblimin për objektet e siguruara, të cilat janë shkatërruar ose dëmtuar nga stuhia.

-Shkatërrimi ose dëmtimi që do të shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhisë.

-Shkatërrimi ose dëmtimi që do të shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjesë të ndërtesës, pemë ose objekte të tjera brenda objekteve të siguruara ose ndërtesës në të cilën janë vendosur objektet e siguruara.

- Është pasojë e humbjes ose dëmit të shkaktuar nga stuhia, në objektet e siguruara ose në elementë të këtyre objekteve.

d. Sigurimi nga rreziku i përmbytjeve dhe rrëshqitjes së tokës

Afati i policës së sigurimit të pasurisë - 1 vit.

3. Bashkëlidhur është lista e aseteve me vlerat e tyre të cilat do sigurohen për vitin 2026.